# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6900
E shtunë, 20 maj 2023
Çmimi 0.40


## Policia pranon donacion nga UNDP-ja pajisje të specializuar për detektimin e eksplozivëve

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


BETOHET KRYETARI I RI I MITROVICËS SË VERIUT FAQE 4-5

# NIS PUNËN KRYETARI I RI I MITROVICËS SË VERIUT



Erden Atiq nga Lëvizja Vetëvendosje është betuar si kryetar i Mitrovicës së Veriut, komunë e banuar me shumicë serbe. Ai është një nga katër kryetarët e zgjedhur në veri të Kosovës në zgjedhjet lokale që u bojkotuan nga serbët. Në ndërtesën e komunës së Mitrovicës së Veriut të premten është vendosur flamuri i Republikës së Kosovës. Tre kryetarët e tjerë nuk dihet kur dhe si do ta nisin detyrën



## CHOLLET: NUK PO SHOHIM ZBATIM TË MADH TË MARRËVESHJES DREJT NORMALIZIMIT

FAQE 3

## BAJRAMI: PO NA QEVERISIN PRAKTIKANTËT ME RREGULLAT DHE URDHRAT E 'KOMITETEVE'

FAQE 7




## AKTUALE



### RUSIA E VENDOS PROKURORIN E GJNP-së NË LISTËN E PERSONAVE TË KËRKUAR F. 2

### KURTI: NË QEVERINË TONË KA MINISTRA, ZËVENDËSMINISTRA, KËSHILLTARË DHE EKSPERTË QË VIJNË NGA DIASPORA F. 5

### BARDHYL MAHMUTI: BURGUN E DUBRAVËS E BOMBARDOI AVIACIONI I SERBISË E JO I NATO-S! F. 6

## EKONOMI



### HAPET FABRIKA "FRESSIA", E CILA PUNËSON PERSONA ME NEVOJA TË VEÇANTA F. 8

### TERMOCENTRAL DIELLOR ME KAPACITET 150 MW NË FSHATIN BEC TË GJAKOVËS, FILLOJNË PUNIMET F. 8

## SPORT



### KB PEJA: KËSHTU FLUTUROJNË SHQIPONJAT, MITROVICA ËSHTË ZEMRA E KOSOVËS F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Rusia e vendos prokurorin e GjNP-së në listën e personave të kërkuar

**Moskë, 19 maj** - Autoritetet ruse e kanë vendosur prokurorin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Karim Khan, në listën e personave "në kërkim", pasi gjykata me bazë në Hagë, ka lëshuar fletarrestim për presidentin rus, Vladimir Putin, në mars të këtij viti.
Fotografia e Khanit tani është në databazën e Ministrisë së Brendshme të Rusisë.
Në njoftim, ai përshkruhet si burrë i lindur më 30 mars 1970, në Skoci, mirëpo aty nuk përmendet asnjë shkelje.
Në muajin mars, Rusia e ka nisur një rast penal ndaj Khanit, pasi Gjykata Ndërkombëtare Penale ka lëshuar fletarrestim ndaj Putinit, me akuzat për krimin e luftës - dëbimin e paligjshëm të fëmijëve ukrainas.
Gjykata ka lëshuar fletarrestim edhe ndaj Maria Lvova-Belovas, komisionares ruse për të Drejta të Fëmijëve.
Komiteti Hetues i Rusisë, i cili heton krimet e mëdha, ka thënë në mars se Khan është hetuar për "gjykim penal të një personi, që është i pafajshëm".
Ai është duke u hetuar edhe nën dyshimet se ka përgatitur "një sulm ndaj një përfaqësuesi të një shteti të huaj që gëzon mbrojtje ndërkombëtare", kanë thënë hetuesit.
Kievi ka thënë që më shumë se 16.000 fëmijë ukrainas janë dëbuar në Rusi, prej nisjes së luftës së Moskës në Ukrainë, në shkurt të vitit 2022.
Rusia, e cila nuk është anëtare e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, ka thënë se fletarrestimet janë të "pavlefshme".
Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky e ka përshëndetur vendimin e gjykatës si "historik".
Presidenti amerikan, JoeBiden, pati thënë se fletarrestimi ndaj Putinit ka qenë "i justifikuar".
Presidenti Putin e quan luftën si "operacion special ushtarak" për të çmilitarizuar Ukrainën.
Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra.
Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



# Berlusconi lirohet nga spitali pas 45 ditësh



**Milano, 19 maj** - Ish-kryeministri italian, Silvio Berlusconi, është liruar të premten nga spitali, pas një trajtimi 45-ditor.
Berlusconi, 86-vjeçar, është larguar nga spitali San Raffaele në Milano, dhe është parë duke i përshëndetur gazetarët.
Ai është shtruar në spital në fillim të muajit prill, për shkak të pneumonisë, dhe mjekët kanë thënë se ai është trajtuar edhe për leukemi kronike.
Politikani dhe manjati i medieve ka qenë në kujdes intensiv për gati dy javë.
Kryeministrja italiane, Giorgia Meloni, ka thënë të premten në Twitter se pret që bashkëpunëtori i saj konservator të kthehet, për "të luftuar shumë beteja tjera bashkë".
Berlusconi e ka formësuar jetën politike italiane për disa dekada.
Popullisti i krahut të djathtë, ka qenë kryeministër katër herë, me disa pauza, prej vitit 1994 deri më 2011.
Ai aktualisht e ka një ulëse në Senat, një prej dhomave të parlamentit në Romë.
Berlusconi ka pasur probleme shëndetësore me vite.
Në fund të vitit 2020, ai është infektuar me koronavirus, ndërsa më 2016 i është nënshtruar një operimi në zemër.

# Senati amerikan propozon një projektligj të ri për Ballkanin Perëndimor

**Uashington, 19 maj** - Kryetarja e Nënkomisionit për Evropën në Komisionin për Marrëdhëniet me Politikën e Jashtme të Senatit Amerikan, senatorja Jeanne Shaheen, me mbështetjen e kolegëve të saj nga të dyja partitë politike, propozoi edhe një herë "Projektligjin për Demokracinë dhe Prosperitetin e Ballkanit Perëndimor" në mbledhjen e fundit të Senatit.
Me mbështetjen e senatorëve Roger Wicker, Ben Cardin, Dick Durbin dhe Chris Van Hollen, propozimi i senatores demokrate është promovimi i bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, por edhe bashkëpunimi i tyre me ShBA-në në fushën e sigurisë kibernetike dhe qëndrueshmërisë kibernetike, duke pasur parasysh "përpjekjet e dëmshme të Iranit dhe Rusisë për t'i bërë vendet e rajonit objektivin e tyre".
Sipas një deklarate nga faqja e internetit e senatores Shaheen, ligji mbështet "stabilitetin demokratik dhe zhvillimin ekonomik të rajonit, përmes iniciativave në infrastrukturë, tregti dhe antikorrupsion, duke përfshirë formalizimin ligjor të sanksioneve, me qëllim që të pengohen aktorët që udhëheqin aktivitete destabilizuese".
Ligji hyri sërish në procedurën e Senatit të enjten, pak para seancës dëgjimore të Komisionit për Marrëdhëniet me Politikën e Jashtme për Ballkanin Perëndimor.
Pothuajse i njëjti grup senatorësh e propozoi Ligjin në mbledhjen e fundit të Senatit, por nuk u miratua. "Ruajtja e paqes dhe forcimi i demokracisë në Ballkan është me rëndësi kyçe për sigurinë dhe stabilitetin evropian, veçanërisht në kohën kur lufta e paprovokuar e Putinit në Ukrainë vazhdon", tha Shaheen."Ligji im



dypartiak do të forcojë tregtinë dhe investimet midis Shteteve të Bashkuara dhe Ballkanit Perëndimor, do të zhdukë korrupsionin, do të kodifikojë sanksionet kundër aktorëve destabilizues dhe do të dërgojë një sinjal të fortë dypartiak se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara ndaj partnerëve tanë në rajon", tha senatorja demokrate. "Ballkani është shtëpia e një trashëgimie kulturore të larmishme dhe rëndësia e tij gjeopolitike vazhdon të rritet", tha senatori republikan Roger Wicker".
Wicker shtoi se "pushtimi brutal rus i Ukrainës nënvizon rëndësinë e partneriteteve tona ballkanike"."Miratimi i këtij projektligji do të shërbente si një deklaratë e qartë, dypartiake e angazhimit të Shteteve të Bashkuara për të forcuar partneritetet tona diplomatike në rajon", tha ai.
Ligji parashikon krijimin e një nisme rajonale për konkurrencën tregtare dhe ekonomike, kodifikimin e dy udhëzimeve ekzistuese ekzekutive për vendosjen e sanksioneve për korrupsionin dhe kërcënimet ndaj paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor.
Gjithashtu, projektligji synon nisjen e një iniciative për luftimin e korrupsionit, e cila do ta drejtonte Sekretarin e Shtetit të ShBA-së për t'i ofruar asistencë teknike të gjitha vendeve në zhvillimin e strategjive kombëtare për të luftuar korrupsionin.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Chollet: Nuk po shohim zbatim të madh të marrëveshjes drejt normalizimit



PRISHTINË, 19 MAJ - Pavarësisht se liderët e Kosovës dhe të Serbisë nuk e kanë nënshkruar, për Shtetet e Bashkuara, marrëveshja drejt normalizimit të raporteve është marrëveshje ligjërisht e obligueshme, tha këshilltari i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit, Derek Chollet.
Chollet i bëri këto deklarata në Komitetin për Punë të Jashtme të Senatit amerikan, ku u diskutua për politikën e Uashingtonit në Ballkanin Perëndimor. "Nuk po shohim zbatim të madh të kësaj marrëveshjeje nga asnjëra palë", deklaroi Chollet.
Chollet gjatë fjalës hyrëse tha se rajoni i Ballkanit Perëndimor është prioritet për administratën e presidentit amerikan Joe Biden.
Duke folur për raportet mes Kosovës dhe Serbisë, ai tha se ato paraqesin sfidën kryesore në këtë rajon. Chollet përsëriti se rruga evropiane e të dyja shteteve nuk mund të ndodhë nëse ato nuk i zgjidhin mosmarrëveshjet ndërmjet vete.
Marrëveshja drejt normalizimit, sipas Chollet, do të sjellë përfitime për të dyja shtetet, duke shtuar se ShBA-ja vazhdon t'i inkurajojë palët që t'i zbatojnë zotimet e tyre.
Zyrtari i lartë i DASh-it tha se ShBA-ja inkurajon liderët e Kosovës dhe Serbisë që të vazhdojnë zbatimin e marrëveshjes, pasi tha se ata duhet të kenë kurajë që të "ndërmarrin rrezique" që të shtyjnë përpara këtë proces.
Gjatë seancës, senatori Chris Murpy e pyeti këshilltarin Chollet për shembujt evropianë që mund të përdoren nga Kosova si model për themelimin e Asociacionit dhe se si ai nuk do të shndërrohej në një Republikë Sërpska. "Sipas pikëpamjes sonë, Asociacioni bazohet në Kushtetutën e Kosovës dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ne duam që të gjithë qytetarët e Kosovës të jenë në gjendje të marrin shërbime të barabarta dhe t'iu dëgjohet zëri. Ideja është që serbët në veri të Kosovës të jenë më pak të varur nga Beogradi dhe [Asociacioni] të fokusohet në edukim, shëndetësi dhe zhvillim lokal ekonomik, e gjëra të ngjashme. Kemi qenë shumë të qartë, ne nuk do të pranojmë e as mbështesim diçka që sadopak do t'i ngjasonte Republikës Sërpska. Siç thatë, BE-ja ka dhjetëra shembuj brenda BE-së struktura të ngjashme me Asociacionin, si në veri të Italisë, në Zvicër, në Finlandë, ku ka minoritete, ku ka një lloj shkalle të kontrollit lokal mbi pjesë të jetës së tyre", tha Chollet.
Në këtë seancë mori pjesë edhe i dërguari i posaçëm i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar.

## Senatori amerikan: S'ka garanci që Asociacioni nuk do të jetë një Republika Sërpska

Ndërkaq, kryetari i Komitetit për Punë të Jashtme të Senatit amerikan, Bob Menendez, tha se në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë jo të gjitha palët po dialogojnë në mirëbesim.
Menendez tha se presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, publikisht është deklaruar se nuk do ta respektojë marrëveshjen drejt normalizimit. Ai shtoi se ndaj Beogradit nuk po ushtrohet presion, teksa shtoi se Vuçiqi po vazhdon të përqafojë narrativë nacionaliste. "Pas arritjes së marrëveshjes presidenti serb Aleksandar Vuçiq mbajti një fjalim publik duke mos u pajtuar me përmbajtjen e marrëveshjes dhe refuzoi ta nënshkruante atë pasi ende nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Kjo është pjesë e sjelljes së Vuçiqit, që thotë një gjë para liderëve perëndimorë dhe thotë diçka tjetër për popullin serb, përmes medieve të kontrolluara nga shteti. Duke kontrolluar sferën e informacionit dhe duke shtypur shoqërinë civile, Vuçiq vazhdon të përqafojë narrativët nacionaliste që pasqyrojnë idenë e 'Serbisë së Madhe', që është e ngjashme me vizionin e [presidentit rus, Vladimir] Putin për 'Rusinë e Madhe'", tha senatori Menendez.
Ai foli edhe për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë dhe rrezikun e krijimit të një Republike Sërpska. "Nuk ka garanci që Asociacioni nuk do të bëhet një Republika Sërpska sikurse në Bosnjë-Hercegovinë", paralajmëroi Menendez në nisje të kësaj seance të komitetit.

## Escobar: Nuk duam një Republika Sërpska të re

Por, Escobari tha se ShBA-ja nuk dëshiron që Asociacioni të jetë një lloj Republike Sërpska. Ai tha se ShBA-ja dëshiron që Kosova të marrë për bazë ndonjë model evropian "që nuk shkel sovranitetin, funksionalitetin apo strukturën kushtetuese" të shtetit.
"Ne duam të shohim që Asociacioni të vendoset nën strukturën kosovare, që ata ta kontrollojnë atë", deklaroi Escobar. Ai tha se BE-ja veçse ka ofruar disa modele të tilla, që nuk e shkelin kushtetutshmërinë e shtetit.
Escobari tha se pesë shtetet e BE-së, që ende nuk e njohin Kosovën, presin zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Serbinë. Ai tha se nga Kosova presin që të zbatojnë Asociacionin. "Nga pala kosovare, njerëzit po presin zbatimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Nuk mund të shmanget Asociacioni që Kosova të lëvizë drejt integrimit evropian", tha Escobari.
I dërguari i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor po ashtu tha se arritja e Marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë, ishte një "hap i madh". "Siç e tha edhe Chollet, një pengesë e madhe për arritjen e paqes dhe prosperitetit në Ballkanin Perëndimor janë raportet e pazgjidhura midis Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja drejt normalizimit të raporteve dhe Aneksi për zbatimin e saj ishin hapa të mëdhenj për arritjen e paqes dhe parashikueshmërisë së raporteve mes dy shteteve", theksoi Escobari.
Një ditë para paraqitjes së tij në Komitetin për Punë të Jashtme të Senatit amerikan, Chollet zhvilloi biseda të ndara telefonike me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq.
Me të dy zyrtarët, Chollet bisedoi për dialogun që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian ndërsa porositi palët që të vazhdohet puna e rëndësishme për zbatimin e Marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve dhe duke kërkuar nga palët që t'i shmangin provokimet.
Bashkimi Evropian ndërmjetëson dialogun mes Kosovës dhe Serbisë që nga viti 2011. Ky proces, që gëzon mbështetjen e ShBA-së, synon të çojë palët drejt normalizimit të plotë të raporteve.
Më 27 shkurt, Kosova dhe Serbia në Bruksel arritën Marrëveshjen Bazë drejt normalizimit të raporteve dhe më 18 mars, në Ohër u pajtuan për Aneksin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.
Marrëveshja, prej 11 nenesh, nuk përmend në mënyrë specifike njohjen e ndërsjellë, por kërkon nga palët që t'i pranojnë dokumentet dhe simbolet e njëra-tjetrës, përfshirë: pasaportat, diplomat dhe targat.
Po ashtu, Marrëveshja e Ohrit kërkon që palët të zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, të cilin Qeveria në Prishtinë e ka refuzuar deri më tash, me arsyetimin se mund të rrezikojë funksionalitetin e shtetit.
Shtetet e Bashkuara kanë thënë se Asociacioni është prioritet, teksa Escobar ka deklaruar se zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit duhet të nisë me Asociacionin.
Në takimin e fundit të dialogut të nivelit të lartë, që u mbajt më 2 maj, Ekipi Menaxhues për formimin e Asociacionit, ka paraqitur para palëve draftin e parë të statutit për themelimin e Asociacionit.
Ky draft është refuzuar nga pala kosovare.
Qeveria e Kosovës ka shkarkuar Ekipin Menaxhues që ka hartuar statutin për Asociacionin, me arsyetimin se ky ekip ka përfunduar mandatin me prezantimin e draftit. Por, ky veprim i ekzekutivit kosovar në BE është konsideruar se është në kundërshtim me marrëveshjen e dialogut. Blloku evropian ka shprehur qëndrimin se ky ekip - i përbërë nga katër anëtarë serbë - duhet të jetë funksional deri në miratimin e statutit të Asociacionit.
Kosova dhe Serbia kanë arritur dy marrëveshje për Asociacionin, më 2013 dhe 2015. Por, Marrëveshja mbi parimet për themelimin e Asociacionit, sipas Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nuk është në harmoni të plotë me aktin më të lartë juridik të shtetit. Megjithatë, Kushtetuesja ka thënë se ajo mund të harmonizohet me akte ligjore.



BETOHET KRYETARI I RI I MITROVICËS SË VERIUT

# Nis punën kryetari i ri i Mitrovicës së Veriut

**Erden Atiq nga Lëvizja Vetëvendosje është betuar si kryetar i Mitrovicës së Veriut, komunë e banuar me shumicë serbe. Ai është një nga katër kryetarët e zgjedhur në veri të Kosovës në zgjedhjet lokale që u bojkotuan nga serbët. Në ndërtesën e komunës së Mitrovicës së Veriut të premten është vendosur flamuri i Republikës së Kosovës. Tre kryetarët e tjerë nuk dihet kur dhe si do ta nisin detyrën**

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 MAJ - Kryetari i ri i Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq, të premten ka bërë betimin para Kuvendit Komunal, procedurë kjo solemne për të marrë detyrën si kryetar. Atiq në këtë seancë e ka emëruar edhe nënkryetaren e komunës, që është Katarina Axhançiq nga radhët e komunitetit serb. Pas betimit, Atiq para medieve ka thënë se do të punojë me të gjithë qytetarët pa dallim. "Ne me gjithë ekipin do të punojmë për të gjithë qytetarët pa dallim dhe pa diskriminim. Angazhimin më të madh do ta bëjmë për ta normalizuar këtë pjesë të komunës. U bëj ftesë të gjithë qytetarëve që të na takojnë, të na vizitojnë dhe të bashkëpunojmë sa më mirë për të mirën e qytetarëve", ka deklaruar Atiq në një deklaratë për medie pas betimit.

Kurse nënkryetarja Axhançiq ka thënë se ajo mendon se është koha për të folur për prioritetet e qytetarëve në veri. "Qytetarët tanë meritojnë ta bëjnë jetën e tyre më të lehtë dhe më të mirë. Vendosëm që të kemi një ekip të mirë, bashkëpunim të mirë me qytetarët dhe së bashku do të bëjmë gjithçka që mund të bëhet", është shprehur Axhançiq. Ajo ka shtuar se nuk ka pasur takime me përfaqësuesit e komunitetit serb në veri, por ka paralajmëruar se do ta bëjë një gjë të tillë.

Në ndërtesën e komunës së Mitrovicës së Veriut të premten është vendosur flamuri i Republikës së Kosovës.

Nënkryetari i Listës Serbe, Igor Simiq, në një konferencë për medie të premten, ka thënë se me dhënien e betimit "filloi zyrtarisht pushtimi i veriut e do të përfundojë kur të vendosin serbët".

Simiq i ka dhënë afat kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, deri më 1 qershor për ta "ndaluar represionin, shpronësimin, arrestimin, persekutimin dhe sulmet ndaj serbëve". Dhe "nëse vazhdon, përgjigjja e popullit serb do të pasojë më 1 qershor, ata do ta mbrojnë veten me të gjitha mjetet", tha Simiq duke mos cekur se cilat janë këto mjete.

Ndërsa drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviq, e ka quajtur "pushtim" ardhjen në detyrë të kryetarit të ri të Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq, duke thënë se me veprimet e tyre "Kurti dhe Prishtina [zyrtare] duan ta dëbojnë popullin serb nga Kosova dhe të provokojnë luftë".

Ai ka thënë se është e papranueshme që dikush që ka fituar kaq vota tash ta udhëheqë komunën e Mitrovicës së Veriut. "Simboli i atij pushtimi dhe ajo leckë [flamuri i Kosovës] që e kanë ekspozuar në ndërtesën komunale të Mitrovicës… nuk do të jetë kurrë flamur për ne. Do të qëndrojë atje për aq kohë sa vetë pushtimi, dhe kjo do të thotë jo për shumë kohë", ka thënë Petkoviq në një konferencë për medie pas betimit të Atiqit si kryetar i komunës.

Në zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale të mbajtura më 23 prill, Atiq nga Lëvizja Vetëvendosje fitoi rreth 550 vota ose 66 për qind të votave. Pjesëmarrja në zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale ishte 3.47 për qind e trupit zgjedhor.

Por, të premten nuk e kanë bërë betimin edhe tre kryetarët e tjerë të rinj të komunave në veri.

Në Komunën e Leposaviqit kryetar i ri është zgjedhur Lulzim Hetemi nga Vetëvendosja, në atë të Zveçanit, Ilir Peci nga Partia Demokratike e Kosovës, ndërsa Zubin Potokun do ta udhëheqë Izmir Zeqiri po nga PDK-ja.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, janë 30 ditë afat pasi që certifikohen zgjedhjet për kryetarë të komunave, deri kur kryetarët duhet ta bëjnë betimin para Kuvendit Komunal për ta marrë detyrën. Përndryshe humbasin mandatin.

Megjithatë, sipas ministrit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, në ato komuna ku kuvendi komunal nuk është konstituuar ende, ekzistojnë edhe disa afate



# Kurti: Në qeverinë tonë ka ministra, zëvendësministra, këshilltarë e ekspertë që vijnë nga diaspora



PRISHTINË, 19 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, mori pjesë në edicionin e tretë të konferencës "Diaspora Flet", e organizuar nga organizata GERMIN me mbështetje të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Në fjalën e tij, Kurti tha se diaspora shqiptare ka luajtur dhe vazhdon të ketë një rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin ekonomik, social dhe politik të Kosovës.

Ai tha se brenda dyvjeçarit të parë të mandatit të tyre qeverisës kanë arritur t'i përfshijnë në diskutim mbi 20 qendrat kryesore ku jeton dhe vepron mërgata. "Gjithashtu, jemi angazhuar për të ofruar mënyra inovative për të përfshirë diasporën në proceset e hartimit të politikave duke u bërë pjesëmarrës aktiv në jetën e përditshme të vendit tonë. Andaj, në Qeverinë tonë ka ministra, ka zëvendësministra, këshilltarë e ekspertë të angazhuar, të cilët vijnë nga diaspora", ka deklaruar Kurti.

Kryeministri Kurti u shpreh se po përmbushet edhe një zotim tjetër i qeverisjes sa i përket procesit të votimit, i cili, sipas tij, parasheh që mërgata të ketë lehtësim real të shprehjes së vullnetit politik, teksa ambasadat dhe konsullatat e Republikës gjatë zgjedhjeve do të shndërrohen në qendra të votimit.

Gjatë konferencës Kurti deklaroi se bashkë me Shqipërinë, janë duke punuar te pjesa e mësimit plotësues, në veçanti ofrimi i librave për fëmijët, që vijojnë mësimin plotësues të gjuhës shqipe, por edhe në planin e përbashkët për të adresuar sfidat e shumta që kemi për të ruajtur gjuhën shqipe jashtë vendit.

Andaj, theksoi ai, këtë verë, në kuadër të Seminarit të Përbashkët të Gjuhës Shqipe, që do të mbahet në Shqipëri, theksi do të jetë te koncept-dokumenti për adresimin e sfidave që kemi para me mësimin plotësues të gjuhës jashtë vendit.

## Mehaj takon ambasadorin Minxhozi: Bashkëpunimi me Shqipërinë, i pandashëm



Prishtinë, 19 maj - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur në takim ambasadorin e Shqipërisë, Qemal Minxhozi, me të cilin ka biseduar lidhur me mbledhjen e radhës të planifikuar mes qeverive të të dy vendeve. Në këtë takim u theksua të bëhet identifikimi i fushave në të cilat duhet lehtësohen procedurat dhe të eliminohen barrierat. "Bashkëpunimi e koordinimi me Shqipërinë është i natyrshëm dhe i pandashëm nga aktiviteti ynë", ka deklaruar ministri Mehaj.

## Osmani: Kryetarët e komunave veriore të betohen brenda afateve ligjore

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të premten se e rëndësishme është që kryetarët e rinj të katër komunave në veri të Kosovës të kryejnë betimin brenda afateve ligjore. Disa orë pas betimit të Erden Atiqit, si kryetar i Mitrovicës së Veriut, Osmani ka thënë se kryetarët e asaj pjese duhet t'i bindin qytetarët se projektet do të jenë në të mirë të tyre. "Shërbimet administrative janë në të mirë të tyre, siguria është në të mirë të tyre. Projektet ekonomike i fuqizojnë ata, pra secili veprim është për të mirën e qytetarëve dhe jo të kundërtën, dhe ne presim që të gjitha këto procedura të shkojnë pa ndonjë problem dhe pa ndonjë tension", ka thënë Osmani.

Sipas presidentes, edhe mbajtja e zgjedhjeve në muajin prill të këtij viti ka qenë obligim ligjor dhe kushtetues. "Ajo që e ka shtyrë këtë situatë ka qenë dorëheqja e ish- kryetarëve të komunave në veri", ka thënë Osmani, duke shtuar se bojkotimi i zgjedhjeve nga pjesëtarët e komunitetit serb nuk ka qenë vullnetar, por i detyruar nga presidenti i Serbisë, AleksandarVuçiq. "Dhe është zbatuar nga strukturat e tij ilegale dhe kriminale në veri të Kosovës, të cilat vazhdimisht kanë frikësuar, shantazhuar dhe kërcënuar qytetarët serb në veri", ka thënë Osmani.

ligjore dhe procedura deri të nisë rrjedhja e afatit ligjor prej 30-ditësh për kryetarin.

Pas betimit të kryetarit të Mitrovicës së Veriut, mbeten të bëjnë betimin edhe ata të komunave Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Nga të tri këto komuna, vetëm Zubin Potoku ka asamble funksionale. "I kemi dy situata. Kemi dy kuvende komunale njëjtë sikur Mitrovica e Veriut ku ka kuvend ku duhet të organizohet vetëm seanca e dhënies së betimit të kryetarit", tha Krasniqi, pa treguar se kur pritet të bëhet betimi për kryetarin e Zubin Potokut.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, tha më 18 maj se nuk duhet përdorur forca për të fituar qasje në ndërtesat komunale në veri. Ai theksoi se është e rëndësishme që të shmangen konfliktet dhe rritja e tensioneve në terren. "Ne presim nga kryetarët e zgjedhur që të



ushtrojnë rol teknik, në vend të atij politik, dhe të ndërmarrin veprime që nuk shihen si përshkallëzuese", tha Hovenier.

Kryetarët e rinj të Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit e kanë pranuar se do të jetë sfidë për ta dhe kabinetet e tyre qasja fizike në objektet e komunave, sepse në to janë të pranishme edhe strukturat e të ashtuquajturave organe të përkohshme që punojnë sipas sistemit të Serbisë.

Bashkësia ndërkombëtare ka njohur ligjshmërinë e zgjedhjeve lokale të 23 prillit, por ka shprehur keqardhje për mospjesëmarrjen në zgjedhje të partive nga komuniteti serb.

## Për herë të parë në QKUK bëhet thyerja laserike e gurëve në traktin urinar te një fëmijë trevjeçar

**Prishtinë, 19 maj** - Shërbimi Klinik Universitar i Kosovës ka bërë me dije se në Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijëve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovë për herë të parë u realizua me sukses thyerja (lithotrsipsia) laserike e gurëve në traktin urinar te një fëmijë trevjeçar.

Në njoftim thuhet se ky intervenim u realizua në bashkëpunim të ngushtë në mes të ekipit profesional të kirurgëve pediatrikë të Klinikës së Kirurgjisë së Fëmijëve, Klinikës së Anesteziologjisë dhe me specialistë të Klinikës së Urologjisë. "Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve tani në ambientet e Spitalit të ri të fëmijëve 'Sheikha Fatima' po vazhdon të zgjerojë gamën e shërbimeve intervente endoskopike me metoda minimale invazive, me qasje dhe pajisje bashkëkohore dhe kjo fal angazhimit e profesionalizmit të personelit të specializuar në këtë fushë", thuhet në njoftim.



# Bardhyl Mahmuti: Burgun e Dubravës e bombardoi aviacioni i Serbisë e jo i NATO-s!



**Prishtinë, 19 maj** - Kryetari i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur", Bardhyl Mahmuti, ka thënë se burgun e Dubravës e bombardoi aviacioni i Serbisë e jo i NATO-s. "Bombardimi i caqeve civile shqiptare nga aviacioni serb u shoqërua me një propagandë të paparë nga ana e ministrit të atëhershëm të Informacionit në Qeverinë e Serbisë, Aleksandar Vuçiqit, për ta fajësuar NATO-n për këto aksione. Duke fshehur krimin dhe duke fajësuar NATO-n, Serbia kreu një krim të dyfishtë! Përkundër asaj se në konferencën për shtyp në Pentagon, të datës 21 maj 1999, ShBA demanton në mënyrë të argumentuar se prapa këtij krimi nuk qëndrojnë forcat e NATO-s. Propaganda e Joseph Goebbelsit ballkanik krijoi huti kaq të madhe saqë sot e kësaj dite shpërndahen, në mënyrë të pavetëdijshme, sajesat serbe", ka thënë ai.

Bardhyl Mahmuti ka thënë se në 24-vjetorin e fillimit të krimit të gjenocidit në Burgun e Dubravës përkujtojnë 19 majin e vitit 1999, kur aviacioni serb bombardoi pavijonin C1 të këtij burgu dhe vrau tre kolos të çështjes sonë kombëtare dhe të luftës së UÇK-së: Enver Topallin, Abdullah Tahirin dhe Gjokë Ndrecajn. "Gjatë periudhës 19-23 maj 1999 forcat serbe kryen njërin ndër aktet më të rënda gjenocidare që njihet me emrin 'Masakra e Dubravës', gjatë së cilës u vranë 117 shqiptarë dhe u plagosën rreth 400 të tjerë. Lavdi Enver Topallit! Lavdi Abdullah Tahirit! Lavdi Gjokë Ndrecajt! Qoftë i përjetshëm kujtimi për të gjitha viktimat e gjenocidit!", ka thënë Mahmuti.

# Lladrovci takon Rainer Wielandin

**Drenas, 19 maj** - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka takuar zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian, Rainer Wieland.

Lladrovci ka theksuar se "ishte rast të diskutojmë për marrëdhënien e pushtetit lokal dhe pushtetit qendror dhe mundësinë e marrjes së përvojave të mira nga ana jonë prej Asociacionit të komunave të Baden Wyrtembergut". "Drekë miqësore me zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian, mikun tonë, Rainer Wieland, në Prishtinë. Ishte rast të diskutojmë për marrëdhënien e pushtetit lokal dhe pushtetit qendror dhe mundësinë e marrjes së përvojave të mira nga ana jonë prej Asociacionit të komunave të Baden Wyrtembergut. Faleminderit 'Qytetar Nderi' i komunës tonë, Wieland për dhuratën e librit të kryetares së parë të Parlamentit Evropian, LouiseWeiss", ka shkruar Lladrovci në "Facebook".




# Haxhiu merr vendim për suspendimin e një përmbaruesi



**Prishtinë, 19 maj** - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka marrë vendim për suspendimin e përmbaruesit Irfan Kërçagu deri në marrjen e një vendimi të Komisionit Disiplinor.

Ministrja thotë se profesionet e lira duhet t'u shërbejnë qytetarëve dhe institucioneve e jo të kontribuojnë në dëmtimin e tyre. "Bazuar në kompetencat ligjore, sot kam nënshkruar Vendimin për suspendim të përmbaruesit Irfan Kërçagu deri në marrjen e një vendimi të Komisionit Disiplinor. Si Ministre e Drejtësisë jam zotuar për mbrojtjen e interesit publik dhe çdo vendim imi do të jetë në linjë me këtë parim. Profesionet e lira duhet t'u shërbejnë qytetarëve dhe institucioneve e jo të kontribuojnë në dëmtimin e tyre", ka theksuar Haxhiu.

Më tutje, ajo ka kërkuar nga të gjithë përmbaruesit që t'i respektojnë përgjegjësitë e tyre. "Duke pasur parasysh ankesat e qytetarëve dhe institucioneve ndaj përmbaruesve, u bëj thirrje të gjithë përmbaruesve që t'i respektojnë përgjegjësitë e tyre sepse nuk do të tolerojmë asnjë tejkalim kompetence apo shkelje", ka theksuar Haxhiu.

## Drejtoria e Inspekcionit ndërpret disa ndërtime pa leje në Mitrovicë

**Mitrovicë, 19 maj** - Drejtoria e Inspeksionit, respektivisht sektori i ndërtimit, në kuadër të inspektimeve të përditshme, ka ndërpreë disa ndërtime pa leje dhe ato që nuk e kanë respektuar lejen e ndërtimit. Këto punime saktësisht janë ndaluar në disa objekte të banimit në rrugën "Hamëz Jashari", "Marie Shllaku", si dhe "Rruga e Shalës", me ç'rast inspektorët komunalë kanë bërë konservimin apo vendosjen e shiritave përreth objekteve.

Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, Valon Brahimi, ka bërë thirrje te të gjithë qytetarët të cilët duan të bëjnë ndërtime të objekteve afariste apo të banimit që të pajisen me leje ndërtimi, përndryshe inspektorati i komunës është i obliguar ta zbatojë ligjin dhe të marrë masa konform ligjit në fuqi.



# Bajrami: Po na qeverisin praktikantët me rregullat dhe urdhrat e ‘komiteteve’

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 19 maj - Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se janë duke ikur profesionistët shëndetësorë, mësuesit, punëtorët e administratës, të gjithë ata që me kontrata në sektorin publik më herët ndiheshin të sigurt, merrnin kredi dhe e planifikonin jetën në Kosovë. “Na kujtohet se si LV pati premtuar kthimin e trurit në Kosovës dhe shihni se çfarë po ndodhë. 11 ministri janë me ushtrues detyre të pozitës së sekretarit të përhershëm, pozitës me të lartë ekzekutive në ministri. Fondi Pensional pa bord. Banka Qendrore pa guvernator, Komisioni i Ndihmës Shtetërore jofunksional. Njësia e inteligjencës financiare pa drejtor. Administrata Tatimore pa drejtor”, ka shkruar Bajrami në “Facebook”.

Ajo ka thënë se vetëm 40 milionë euro janë shpenzuar për investime kapitale në tremujorin e parë të këtij viti e, sipas saj, qeveria me propagandë mundohet t’i bindë qytetarët për progresin e pashembullt ekonomik në vend. “Sot të gjithë jemi të vetëdijshëm se gjendja ekonomike dhe gjendja në institucione është në pikën me të ultë që nga paslufta. Po na qeverisin praktikantët me rregullat dhe urdhrat e ‘komiteteve’, andaj edhe s’ka si të jetë ndryshe”, ka shkruar Bajrami.



# Policia pranon donacion nga UNDP-ja pajisje të specializuar për detektimin e eksplozivëve

Prishtinë, 19 maj - Policia e Kosovës njoftoi këtë të premte se ka pranuar donacion nga UNDP-ja një pajisje të specializuar për detektimin e eksplozivëve. Kjo pajisje e quajtur Ground Penetration Radar (GPR) për Policinë e Kosovës thuhet se do të jetë një ndihmesë e madhe që edhe më tutje dhe së bashku me autoritetet dhe institucionet e tjera të Republikës së Kosovës të cilat janë duke zbatuar Udhërrëfyesin Rajonal për Kontrollin e AVL-ve në Ballkanin Perëndimor si dhe strategjitë e tjera kombëtare që kontribuojnë në rritjen e sigurisë së përgjithshme në vendin dhe



rajonin tonë. “Siguria është një nga elementet kryesore për çdo shoqëri në botë. Të qenit në gjendje të jetojmë dhe të funksionojmë lirshëm dhe pa frikë nga krimi, është në interes të çdo qytetari, pavarësisht nga mosha, gjinia, raca apo feja. Prandaj, çdo rrezik për sigurinë, dëmton rëndë parimet themelore të të drejtave dhe lirive të njeriut. Pavarësisht përparimeve teknologjike dhe zhvillimeve njerëzore, armët e zjarrit dhe eksplozivët përfshirë prekursorët e tyre vazhdojnë të jenë një rrezik i madh për sigurinë e popullatës”, thuhet në njoftimin për media.

Tutje bëhet me dije se radari i depërtimit në tokë (GPR) është një teknologji e përdorur nga policia në përgjithësi për t’i zbuluar objektet që janë të groposura nën tokë. “Shpesh përdoret nga forcat e rendit për të kërkuar armë të groposura në tokë, municion, eksplozivë, drogë dhe sende të tjera të paligjshme. Duke përdorur GPR, policia mund të kuptojë më mirë një zonë dhe potencialin e saj për fshehjen e provave. Kjo pajisje është një mjet i çmuar për agjencinë e zbatimit të ligjit dhe mund të ndihmojë të gjejnë prova të vlefshme që ndryshe do të ishin të vështira ose të pamundura për t’u gjetur. Policia së Kosovës falënderon UNDP-në dhe donatorët e tjerë për mbështetje dhe bashkëpunim si dhe mbështetje për zbatimin e suksesshëm të projekteve që derivojnë nga Udhërrëfyesi Rajonal për kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta që zbatohet nga të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimorë”, thuhet në njoftim.

# Ministri Vitia: Mjekësia familjare është zemra dhe skeleti i sistemit shëndetësor

Prishtinë, 19 maj - Mjeku familjar është personi kryesor që njeh gjendjen e përgjithshme shëndetësore dhe ka vëzhguar për së afërmi pacientin. Këto të dhëna janë bazament dhe garanci për të ardhmen për evidentimin dhe trajtimin e sëmundjeve të pacientëve me qëllim të preventives dhe mbrojtjes sa më efektive në rastet kur shëndeti i tyre rrezikohet. Kështu tha të premtenministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, në shënimin e Ditës Botërore të Mjekëve familjarë.

Ai theksoi se Qendrat e Mjekësisë Familjare janë adresa e parë e qytetarëve për shëndetin e tyre, ndërsa roli i ekipeve të kujdesit parësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore është i një rëndësie të veçantë. “Kjo u dëshmua edhe në ballafaqimin me pandeminë Covid-19 kur kontributi i mjekut familjar ishte vendimtar”, ka thënë Vitia.

Më tej, ministri ka theksuar se MSh në politikat e saj i ka kushtuar një rëndësi të veçantë Kujdesit Parësor Shëndetësor. “Me qëllim të zgjerimit të



gamës së shërbimeve dhe ngritjes së cilësisë, nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë janë ndarë 3.4 milionë euro për vizitat në shtëpi për kujdes ndaj nënës dhe fëmijës. Për vizitat në shtëpi për kujdesin paliativ, janë ndarë 2.2 milionë euro. Gjithashtu, janë siguruar pajisjet për shërbimin akut emergjent në 34 komuna. Janë ndarë 2.4 milionë euro për 299 pozita të mjekëve, ndërsa koeficienti i ri më së miri e ka adresuar dhe ka rritur nivelin e rrogave të personelit shëndetësor”, ka thënë Vitia.

## Osmani pret zëvendëspresidentin e PE-së, temë diskutimi integrimi i Kosovës në BE

Prishtinë, 19 maj - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premten në takim zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian, Rainer Wieland.

Në takim u bisedua për procesin integrues të Republikës së Kosovës në Bashkim Evropian si dhe zhvillimet e fundit në vend dhe rajon.

Presidentja Osmani shprehu mirënjohjen e Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme të Parlamentit Evropian për integrimin e Kosovës në BE, ndërsa ka ritheksuar nevojën që kjo mbështetje të vazhdojë.

Ndër të tjera, Osmani ka potencuar përkushtimin e palëkundur të popullit dhe institucioneve të Republikës për integrim në Bashkimin Evropian, e reflektuar edhe në bashkërendimin e plotë me politikat e jashtme dhe të sigurisë me ato të BE-së. Më tutje, presidentja Osmani ka folur mbi angazhimin e Republikës së Kosovës për paqe dhe stabilitet afatgjatë në rajon.



## Hapet fabrika "Fressia" e cila punëson persona me nevoja të veçanta

LIPJAN, 19 MAJ - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë pjesë në përurimin e Fabrikës së Letrës Higjienike dhe Ambalazhit të Letrës "Fressia" në Lipjan, projekt i Fondacionit "Golden Eagle", në të cilën të gjithë të punësuarit janë persona me nevoja të veçanta. Pasi e ka përgëzuar drejtorin e Fondacionit, Shaqir Palushi për këtë nismë, presidentja Osmani ka theksuar se personat me nevoja të veçanta e meritojnë të jenë pjesëmarrës aktivë në botën e biznesit. "Një mjedis gjithëpërfshirës dhe divers ofron mundësi të barabarta për të gjithë, duke nxitur inovacionin, kreativitetin dhe rritjen ekonomike. Duke fuqizuar njerëzit me nevoja të veçanta për të qenë pjesë e bizneseve, ne i thyejmë barrierat dhe i transformojmë jetët e tyre. I inkurajoj edhe bizneset e tjera ta ndjekin shembullin tuaj, duke punësuar sa më tepër persona me aftësi të veçanta", ka theksuar presidentja Osmani në ceremoninë e përurimit të kësaj Fabrike.

Sipas presidentes Osmani, bizneset të cilat punësojnë persona me nevoja të veçanta sfidojnë stereotipat, thyejnë stigmat dhe promovojnë gjithëpërfshirjen. "Duke mbështetur këto biznese ne dërgojmë një mesazh të fuqishëm se secili ka të drejtë t'i ndjekë ëndrrat dhe aspiratat pavarësisht prej aftësive", theksoi Osmani.

Kurse drejtori i Fondacionit, Palushi, ka bërë me dije se të ardhurat që grumbullohen nga shitja e prodhimeve do të shkojnë për personat me nevoja të veçanta.



# Ekonomistët paralajmërojnë zbritje të çmimeve të prodhimeve në Kosovë



PRISHTINË, 19 MAJ - Edhe gjatë muajit maj është vërejtur një ngritje e çmimeve të disa produkteve në Kosovë, megjithëse pati edhe produkte ushqimore që këtë muaj u kushtuan qytetarëve më pak. Këta të fundit thonë se po u duhet të kursejnë më shumë në mënyrë që të mund ta përballojnë blerjen e ushqimeve të nevojshme.

Ekonomistët, ndërkaq, paralajmërojnë zbritje të çmimeve për muajt e ardhshëm, derisa Ministria e Industrisë ka fajësuar opozitën se me dërgimin e Ligjit për çmimet tavan në Kushtetuese ua pamundësoj qytetarëve lirimin e shportës mujore.

Çmimet e larta të produkteve ushqimore po ua varfërojnë shportat ditore qytetarëve. "Të gjitha po janë të shtrenjta, s'ka më të lira. Unë pensionin e kam 200 euro. Para dy vjetëve 200 euro kanë qenë të mëdha, tani çka janë?", thotë një qytetar për RTK-në. "Shumë artikuj janë zbritur, por këtu nuk kanë zbritur fare, prapë kanë mbetur të njëjtat. Po duhemi me kursy shumë sepse nuk po e kemi çare", thotë një tjetër.

Në krahasim me muajt e kaluar, çmimet e disa produkteve ushqimore gjatë majit kanë shënuar ngritje. Por, një pjesë e produkteve ushqimore këtë muaj kushtuan më pak. Kështu, 1 kilogram miell gruri kushtoi mesatarisht 84 centë në prill e rreth 89 centë në maj.

Një bukë e bardhë ka kushtuar rreth 51 centë, ndërsa tani kushton 50 centë. 1 kilogram oriz në prill ishte 1 euro e 61 centë e në maj 89 centë.

Çmimi i një litri qumësht sillet rreth 1 euro e 25 centë, ndërsa 1 litër jogurt kushtoi 1 euro e 16 centë në prill, 1 euro e 19 centë në maj.

Nga Ministria e Industrisë thonë se dërgimi i Ligjit për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Kushtetuese po ua pamundëson qytetarëve që shportën ta kenë më të lirë.

Mirëpo njohës të ekonomisë kanë paralajmëruar rënie të çmimeve gjatë muajve të ardhshëm. "Në bazë të parashikimeve të Bankës Qendrore të Kosovës, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe mekanizmave që merren me hulumtime dhe zhvillim ekonomik, edhe në vendin tonë sikur në rajon do të ketë ulje të çmimeve", thotë Lulzim Beqiri, njohës i ekonomisë.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, çmimet gjatë prillit kishin shënuar rritje për rreth 0.3 % krahasuar me marsin.

## Termocentral diellor me kapacitet 150 MW në fshatin Bec të Gjakovës, fillojnë punimet

PRISHTINË, 19 MAJ - Të premten është mbajtur ceremonia e fillimit të punimeve në projektin e termocentralit diellor me kapacitet 150 MW nga Solar Energy Group Europe në fshatin Bec të komunës së Gjakovës. Në këtë ceremoni ishte i pranishëm edhe kryeministri i vendit, Albin Kurti dhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli.

Ky moment, sipas kryeministrit Kurti, simbolizon jo vetëm një hap të rëndësishëm drejt qëllimeve tona për t'i ngritur kapacitetet nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, por edhe përkushtimin tonë të palëkundur për të krijuar një të ardhme më të ndritshme për vendin tonë.

Teksa veçoi miratimin e Strategjisë së re të Energjisë në Kuvendin e Kosovës, ai theksoi se orientimet e sektorit të energjisë për periudhën 10-vjeçare ne tashmë i kemi vendosur në këtë Strategji, me synimin që zhvillimi i sektorit të energjisë të shkojë drejt tranzicionit energjetik në përputhje me Marrëveshjen e Sofjes dhe Planin e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor 6, si dhe gradualisht drejt neutralitetit ndaj karbonit deri më 2050.

"Sot ne jemi mbledhur këtu për ta shënuar realizimin e vizionit tonë - atë të përpjekjes për pavarësi energjetike dhe transformimit të sektorit drejt energjisë edhe të pastër edhe të qëndrueshme", u shpreh kryeministri para të pranishmëve në këtë inaugurim.



# Asllan Selimi argumenton dhe dëshmon krimin serb në burgun e Dubravës

Nga Nait HASANI

Të kesh në dorë librin "Tmerri ka emër", me kujtime të ngjarjeve më të rëndësishme të kohës që i ka përjetuar Asllan Selimi, e qe këtij populli i dhanë shpresë e gjallëri ne motivin për të qëndruar e rezistuar për mbijetesë, kur në të gjitha anët kishin humbur shpresat nga ngjarjet që kishin kapluar Jugosllavinë dhe rinia nuk shihte shpresë për të qëndruar dhe kërkonte, si të dal jashtë duke i ikur dhunës sistematike të pushtuesit policor e ushtarak të Serbisë dhe bandave kriminale paraushtarake të kolonëve serb në Kosovë. Në këtë libër me kujtime, Asllani na ka përshkruar gjendjen e tij që nga arrestimi i tij në Mitrovicë e deri aty, ku iu ndërpre shkrimi për shkak te fatkeqësisë se ndodhur. (?!) Asllani, inxhinier në studime në Mitrovicë, që në fillet e para të organizimit të UÇK-së ishte angazhuar në fillim me detyra të ndërlidhjes mes Shtabit Operativ dhe Shtabit Qendror me zonën e Drenicës, përmes vëllait të tij, Rexhep Selimit. Ushtria Çlirimtare e Kosovës, tashmë kishte dalë në skenë me aksionet e saj, dhe në popull ishte ngjallur shpresa, se kjo tokë, ky vend, ka djem që i dalin zot atdheut në çdo kohë. Megjithëse përpjekjet, që UÇK-në, ta quajnë: "..e huaj, dorë e zgjatur serbe, nga shërbime te ndryshme", UÇK vepron në ilegalitet të thellë në tërë territorin e Kosovës. Djemve të UÇK-së, ju kishin veshur dhe epitete të ndryshme të krenarisë e trimërisë, duke vlerësuar nga veprimet çlirimtare të ndërmarra kundër pushtuesit serb. UÇK ishte e padukshme dhe ishte kudo, dhe në këtë kohë u bë tmerr i pushtuesit saqë i ndamë dhe kohën: nata ishte e UÇK-së, dita e pushtuesve. Terrenin e kishim të lirë natën, sepse më nuk kishte thuaja policë që lëvizte natën, vetëm me mjete të blinduara mund të qarkullonin. Rritja e UÇK-së natyrisht dhe shtrirja në territor, binte dhe në sy të popullatës liridashëse që kërkonte me ju bashkuar luftës së UÇK-së. Të gjitha këto aksione, natyrisht që i kishte përcjellë shërbimi sekret serbe përmes bashkëpunëtorëve të tyre. Edhe pse, akoma nuk dihej saktë se kush ishte, ata kishin aludimet e tyre dhe pas arrestimit të një grupi të UÇK-së nga Drenica i hapi rrugë dhe njohjes me UÇK-në të policisë. Arrestimet e janarit të 1997 ishin goditje e rëndë për UÇK-në, vrasjet dhe burgosjet e anëtarëve të UÇK-së. Arrestimi i Asllanit dhe torturat e përjetuara në sigurimin e shtetit serb, janë një dëshmi e mjaftueshme e përgjithësimit të torturave që kem përjetuar të gjithë të arrestuarit. Një dhunë sistematike e pandërprerë me të gjitha metodat më barbare të inkuizicionit mesjetar, deri te torturat me dritë e pagjumësi me netë të tëra së bashku me shkreptimën e elektroshokut ishin çmendurake. Por, pavarësisht torturave e dhunës, qëndresa ishte e pathyeshme përpara gjakpirësve serb, që është një admirim i veçantë i njerëzve të përgatitur për sakrifikim deri në vdekje për lirinë e atdheut dhe çlirimin e Kosovës. Daljen përpara gjykatëses hetuese serbe, Danica Marinkoviq tregon sistemin represiv serb që ishte i ngjashëm në të gjitha proceset hetuese. Asllani na përshkruan mjaft mirë dhe me merak që pas gjithë atyre torturave që në gjyq të tregoj se ai është UÇK, me gjithë kundërshtimet e avokatit, duke luajtur lojën për të shpëtuar, se ti i duhesh atdheut jashtë dhe s'ke nevojë me qenë pjesë e burgjeve. Qëndrimi në gjyq për atë që ka menduar të thotë e nuk mundi ta thotë, ishte një brengë e madhe, por atë që nuk mundi ta thotë Asllani e thashë unë (Nait Hasani) ku ai e citon me fjalë: "Me vjen keq që unë nuk kam mundësi të ju ndihmoj shokëve për të luftuar për liri dhe ju mund të më dënoni dhe me 101 vjet burgim, por nuk do të mund ta ndalni pavarësinë e Kosovës. Kosova do të bëhet e pavarur, o me paqe, o me luftë!". Në kujtimet gjejmë debate, diskutime duke vlerësuar lartë gatishmërinë për qëndrese e vetëflijim, në të mirën e çështjes kombëtare të Asllanit dhe shokëve. Në debate merr krahasime të arsyeshme e logjike në krijimin e unitetit për luftën tonë, çlirimin e atdheut. Në debate ka dhe mospajtime të cilat i tejkalon mirë, sepse këtë ia mundëson ngritja e përgatitja intelektuale, i rritur në familje me tradita kombëtare të Drenicës, e i frymëzuar nga luftërat e Azem Galicës e çetash çlirimtare kaçakësh. Asllani nuk pajtohet në asnjë mënyrë që të burgosurit të kenë përçarje, sepse këtë e donte Serbia. Ai, donte Unitet në qëndresën dhe bashkim të të burgosurve, gjë që në të shumtën absolute të burgosurve politik, qëndronte bashkimi rreth qëllimit politik e ushtarak të luftës sonë dhe sistemit politik në të ardhmen, si Bashkimi Kombëtar. Asllani ka përjetuar rëndë rënien e Mujë Krasniqit e Beqir Gashit me shokë në Pashtrik dhe këtu tregon se kjo luftë është e ashpër, e rëndë dhe vetëm kjo sakrificë mbinjerëzore do ta sjelle lirinë. Në takimin tonë, pas sa kohe që ishim nëpër qelia, ne ndajmë bashkë dhembjen e kujtimet për Mujën, luftën e heroizmat e luftëtarëve. Dhe në diskutime me Ukshin Hotin intelektual me përvojë të jashtëzakonshme dhe për nga mosha e tij, Asllani ishte i ri, por pjekuria politike e ngrinte në nivel politik të kohës e rrethanave ku gjendeshim. Ai i konceptonte debatin si formë e qëndresës në dhunën që bënin organet e burgut sa herë kishin humbje nga UÇK-ja policia e ushtria serbe. Asllani me shkrimet e tij, kronik lufte, burgu e qëndrese, (në formë ditari e kujtese) na tregon se është i përgatitur, jo vetëm si inxhinier, por edhe si intelektual e shkrues i letrave në kujtime. Ai e përshkruan edhe masakrën në Burgun e Dubravës, në një kënd të tij nga një vështrim shumë të saktë dhe profesional. Ai përshkruan bombardimet nga NATO, dhunën e vrasjet më 22 maj 1999 në fushën e sportit nga gardianët, policia dhe të burgosurit serb që tashmë ishin të armatosur. Një përshkrim edhe të mbijetesës në ato rrethana burgu të tmerrit. Ndërsa shpirti i tij njerëzor e humanist, tregohet me dhënien ndihmë të plagosurve në sallën e sportit me shokët që ishin aty, në ndihmë të plagosurve ju jepte vullnet e shpresë në shërimin e tyre. Sallën e sportit e detajon me një saktësi e përmasa me numrin e të burgosurve aty dhe ushtarëve e policëve që ishin në kordon, në hyrje dhe në dritare me shenja JOS (Jeddinice Operativne Serbije) dhe mbledhjen të burgosurve aty. Dhe duhanin kur na shkrepnin dhe ujin si dëshira të fundit dhe pritjen për të na pushkatuar, të gjitha këto i përshkruan, si mija kujtime e vështrime të burgosurve në kujtesën e tyre me familjarët dhe mallin për ta që ndanin në çastet e fundit para pushkatimit. Asllani e përshkruan dhe largimin nga burgu i Dubravës me shumë dhembje e kujdes. Ai shkruan si i lamë shokët tanë të vrarë në oborret e burgut mbi 100 të burgosur dhe mbi 400 të tjerë të plagosur, të ngarkuar në kamionë dhe te traumatizuar nga ai krim makaber. Duke u shkëputur nga aty, ai flet për torturat në burgun e Lipjanit nga gardianët policët dhe ushtarët, flet për vizitën e drejtorit të burgut Lubomir Çimburoviq dhe qëndrimin dyjavor në Lypjan pa ushqim, pa kujdes shëndetësor me dhunë sistematike, deri në një moment, kur natën si para pushkatimit ndezën dritat dhe lidhen me konop të burgosurit, duke prit ekzekutimin. Gjithë këto mendime i vijnë, pas dëgjimit të brohoritjeve në oborr dhe gjuajtjes me armë duke e ve panikun nga e panjohura që e priste. Hipja në autobusë dhe rrugëtimi me duar lidhur dhe me kolona rrugës duke ikur në drejtimin e njëjtë me tanket serbe. Një rrugëtim bukur i gjatë i mundimshëm pa ujë, pa bukë dhe me kërcënime e dajak i bënin ekzekutorët tanë. Ndaljen e autobusëve në burgun e Nishit dhe dhunën e tmerrshme me solidarizimin e të burgosurve serbe me gardianet qe dhunonin me dajak të burgosurit serb është si një çmenduri kriminale. Qëndrimin ne burgun e Nishit, mungesën e ushqimit, dhunën dhe debatet i tregon me një mjeshtëri të hollë të një njeriu profesional të shkrimit të letrave shqipe. Flete për gjendjen emocionale tashmë të marr peng nga regjimi fashist serb. Flet kur e ka kuptuar se Kosova u çlirua nga okupimi serb dhe krenaria, se u arrit qëllimi i luftës sonë dhe UÇK-së. Për Asllanin dhe shokët tashmë vuajtjet e popullit vetëm se kanë marrë fund. Asllani kur na flete për vizitat dhe ato që ju tregoni se a janë gjallë familjaret e tyre që të burgosurit kërkonin të dinin. Na tregon dhe vizitën e nënës që me te, përshkruan të gjitha vizitat e nënave, para dyerve te burgjeve për të parë djemtë e tyre. Tregon pritjet e gjata para dyerve te burgut, pa ujë e pa ngrenë, maltretimin shpirtëror sadist të gardianëve e sigurimit të shtetit për t'u kënaqur, duke i torturuar nënat para burgjeve, dhe mos lejimin për të parë Asllanin, kinse nuk ka një fletë hyrje, këto tmerre të familjarëve janë të përditshme në të gjitha burgjet ndaj të burgosurve politikë thotë Asllani. Ai është edhe shkrues i mirë i botes shpirtërore, ajo duket me një letër dashurie ku i drejtohet të fejuarës së tij Ilires. Ai tregon dhe komunikimin me letra me vëllain Rexhepin nga kupton gjendjen në familje dhe në Kosovë. Ai, po ashtu tregon qëndresën burrërore të Naimit, Naim Lushit që ju kishin vrarë thuaja të gjithë anëtarët e familjes dhe para xhelatëve nuk kishte derdhur asnjë pikë loti dhe thënien se liria ka çmim e fitohet me çmimin e gjakut dhe ja merr këngës, ku mortin e shndërron në këngë, na jep gjithë historinë e tregimeve të legjendave mbi heroizmat popullor të dragonjve, duke luftuar me kuçedrën. Ai këtu flet për debatet, diskutimet, simpatitë politike dhe ligësitë shpirtërore të të burgosurve që lindin nga frika dhe mëshira. Por, i vetëdijshëm për pozicionin e vet, ai është i kujdesshëm me të gjithë dhe duke ju dhënë kurajo qëndresë në burg, si shembull i një ushtari të devotshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Asllanit i ndërpritet shkrimi tragjikisht nga fatkeqësia që e pëson dhe këto kujtime kanë mbetur të pa përfunduara. Por, për aq sa ka shkruar ky, ka treguar se është ushtar i atdheut, me qëndresën e tij, me përballje para torturave të sigurimit të shtetit, të organeve të burgjeve e gardianëve, me të burgosurit shqiptarë. Asllani ka treguar qëndresë, pjekuri politike, mbrojtës i interesit e çështjes kombëtar para interesave të ngushta partiake, Asllani me këtë libër me kujtime të shprehur në kronikë lufte e qëndrese, ka sfiduar të gjithë koleget e vet të burgosur, pse nuk shkruajnë kujtime që të lënë trashëgim me shkrim gjeneratave të reja e popullit tonë për sakrificat e jetës nëpër burgje. Liria ka çmim dhe vlerë kur fitohet me luftë dhe i ka rrënjët në gjak e thotë me qëndresën e tij Asllan Selimi.

Jeta e tij është shembull i sakrificës e qëndresës. e shkruar në librin "Tmerri ka emër" me kujtime lufte, burgje e qëndrese.

*Ky fjalim është mbajtur në përurimin e librit "Tmerri ka emër", i autorit Asllan Selimi






# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# KB Peja: Kështu fluturojnë shqiponjat, Mitrovica është zemra e Kosovës

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

**Pejë, 19 maj** - KB Peja e ka fituar titullin e kampionit në Superligën e basketbollit pas plot dhjetë vitesh. Klubi pejan këtë sukses e arriti falë fitores në ndeshjen e pestë finale ndaj Trepçës në Mitrovicë. Ky sukses e ka bërë krenarë klubin nga Rrafshi i Dukagjinit që përmes një postimi në faqen zyrtare në "Facebook" ka përshkruar rrugën deri të ky sukses historik. "Kështu duken kampionët, kështu fluturojnë Shqiponjat. Klubi i Basketbollit Peja ka hasur në shumë probleme, sfida, vështirësi dhe rreziqe për ta arritur titullin të cilin sonte e kemi fituar. Por të gjithë jemi në dijeni që i ka Peja disa djem, të cilët asnjëherë në këtë jetë nuk do e lejojnë qytetin e tyre në baltë. Shfrytëzojmë rastin ta falënderojmë nga zemra secilin individ, secilën kompani dhe secilin akt i cili pak ose shumë ka ndikuar që KB Peja të stoliset me titullin 'Kampion i Kosovës'. Falënderojmë lojtarët e ekipit tonë, të cilët djersiten uniformen më të bukur në botë për tu shpallur kampion. Ju jeni sonte shpirti i qytetit të Pejës dhe qytetarëve të saj, sonte është nata juaj, sonte së bashku po krijojmë kujtime të cilat nuk do i harrojmë përgjatë gjithë jetës. E ku ka si UCF?? Ku ka si pas ardhësit e Haxhi Zekës? Ku ka si ajo ushtri që asnjëherë nuk u dorëzua deri sa i erdhi koha që ta festojë këtë titull. Shijojeni natën tuaj, ju jeni ata që e mbani qytetin tonë gjallë, ju jeni muskuli më i fuqishëm i kthetrave të Shqiponjës", thuhet në postimin e Pejës. Klubi pejan ka vlerësuar maksimalisht klubin kundërshtar të Trepçës, derisa Mitrovicën e ka quajtur zëmër të Kosovës. "As se si nuk mund të harrohet KB Trepça për luftën e fuqishme të cilën zhvilluan në këto ndeshje finale, jeni ekip për çdo lëvdatë dhe të jeni të bindur se secili qytetar i Kosovës është i vetëdijshëm për këtë. Mitrovica



është zemra e Kosovës. Rivaliteti i jonë në sport është i pamohueshëm, por Kosova dhe dashuria për të qëndron gjithmonë mbi rivalitetet e dëshirat tona sportive. Ju jeni vëllezërit tonë, faleminderit Mitrovicë", thuhet në postimin e klubit të Pejës. KB Peja është rivali kryesori i Sigal Prishtinës në basketbollin e pasluftës. Por, klubi kryeqytetas e ka harruar rivalitetin dhe ua kanë uruar suksesin e fundit rivalëve të tyre nga Rrafshi i Dukagjinit. "KB Peja pas një pritje të gjatë, Urime titullin e fituar me meritë dhe nder! Sporti mbi të gjitha e basketbolli mbi të gjithë. Shihemi sezonin e ardhshëm", thuhet në postimin e Prishtinës.

### KB Trepça: Peja kishte fat, do t'iu gëzojmë edicionin e ri

KB Trepça u mposht në finale nga Peja me rezultat 93:91 duke e humbur mundësin të shpallet kampione e Kosovës në basketboll. Klubi mitrovicas ka reaguar në faqen e tyre në "Facebook", pasi këtij dështimi. Klubi nga Mitrovica iu ka kërkuar falje tifozëve për dështimin, por ka premtuar se në të ardhmen do të luajnë në shumë finale. "E përfunduam një edicion garues, që megjithatë është për ta vlerësuar. Luajtëm të gjitha finalet, fituam trofe, kthyem interesimin për basketbollin në vend dhe sollëm gëzime e emocione. Na mungoi fati dhe titullin e fitoi rivalja jonë, Peja. E urojmë që kishte më shumë fat dhe fitoi titullin e kampionit në një garë të fortë e të barabartë. Duke vlerësuar përkrahjen e secilit prej jush, ju falënderojmë përzemërsisht. Ne jemi ende në rritje. Gjëra edhe më të mëdha na presin prej fillimit të edicionit të ardhshëm. Trepça është e madhe. Me ju në krahë do të luajmë edhe shumë e shumë finale. Do sjellim edhe shumë emocione e krenari. Jemi krenarë që një qytet kemi prapa. Kërkojmë falje që sonte nuk ju gëzuam, por ju premtojnë: shumë gëzime do të keni nga ne. Trepça, krenari", thuhet në reagimin e klubit nga Mitrovica.

# Sot zhvillohet xhiro e parafundit në Superligë

**"Epoka e re"**

**Prishtinë, 19 maj** - Ndeshjet e javës së 36-të në Superligën e Kosovës në futboll zhvillohen sot (e shtunë). Kjo është xhiro e parafundit e këtij sezoni dhe pritet të jetë interesante pasi që në çdo ndeshje pikët janë tejet të rëndësishme, si për titull ashtu edhe për daljen në Evropë dhe mbijetesë. Kampionët në fuqi që e kryesojnë edhe renditjen tabelore, Ballkani mund të shpallet kampion i Kosovës nëse arrin fitore kundër Ferizajt, dhe në rast se Drita ndalet nga Malisheva. Skuadra nga Suhareka aktualisht kryeson tabelën me 69 pikë, dy më shumë së Drita. Ndeshje interesante do të jetë edhe ajo mes Llapit dhe Gjilanit, këta të fundit janë në garë për të siguruar një vend që dërgon në Evropë. Synim për daljen në garat evropian e ka edhe skuadra nga Klina, Dukagjini që përballet me Trepçën '89. Skuadra mitrovicase në anën tjetër është në garë për të mbetur pjesë e elitës. Të gjitha ndeshjet fillojnë në orën 15:00.

**SUPERLIGA /Java e 36-të**

15:00 Ballkani - Ferizaj
15:00 Drita - Malisheva
15:00 Llapi - Gjilani
15:00 Prishtina - Drenica
15:00 Dukagjini - Trepça '89



# Nëntë klube licencohen për garat evropiane, tri nuk licencohen



**Prishtinë, 19 maj** - Komisioni i Shkallës së Parë për Licencimin e Klubeve për garat e UEFA-së, ka marrë vendimet në lidhje me procesin licencues për edicionin 2023/24 të garave të UEFA-së. Në total në këtë proces kanë aplikuar 10 klube nga Superliga e meshkujve dhe dy nga Superliga e femrave. Nga 12 klube, sa e kanë nisur procesin e licencimit, nëntë prej tyre janë licencuar, kurse tri janë refuzuar.
Klubet e licencuara janë: FC Ballkani, FC Drita, SC Gjilani, KF Dukagjini, FC Llapi, FC Malisheva, FC Trepça '89, KFF Mitrovica, KFF EP Hajvalia.
Klubet që nuk janë licencuar për të qenë pjesë e garave të UEFA-së, për edicionin 2023/24 janë: FC Prishtina, FC Ferizaj, KF Drenica.

# Arteta për të ardhmen e Xhakës: Ai është i respektuar në klub

**Londër, 10 maj** - Në ditët e fundit janë shtuar zërat për një largim të mundshëm të Granit Xhakës nga Arsenali. Futbollisti nga Kosova mund të rikthehet në Bundesligë për t'iu bashkuar Bayer Leverkusenit. Për këtë temë ka folur trajneri i "Gunners", Mikel Arteta. "Është e qartë se ai është një lojtar që ka luajtur në çdo minutë që prej se jam bërë trajner këtu. Graniti është një figurë jashtëzakonisht e respektuar në këtë klub. Ai e ka një histori të madhe përreth tij me ato që i ka arritur në klub, duke tejkaluar edhe momente të vështira. Kështu që, ai është një lojtar kyç dhe mjaft i rëndësishëm për ne. Çka do që të ndodhë, është diçka që do ta diskutojmë, natyrisht jo tash", ka thënë Arteta.



## Modriqi: Reali sërish do të rikthehet në majë

Madrid, 19 maj - Luka Modriq mendon se pavarësisht humbjes 4-0 që Real Madrid pësoi në gjysmëfinalen e dytë të Ligës së Kampionëve nga Manchester City, duke u eliminuar, ky nuk është fundi i botës. Fituesi i Topit të Artë ka vlerësuar disa nga shokët e tij të skuadrës, sipas të cilit do ta rikthejnë skuadrën madrilene në majë. "Çdo vit ka yje të rinj në futboll dhe te Real Madrid ka disa të tillë. Mendoj se Vinicius, Rodrygo e ndonjë tjetër që do të vijë në merkaton e verës, do të jenë yjet e rinj të Real Madrid, që do të dominojnë për shumë vite e do ta rikthejnë këtë skuadër sërish në majë", ka thënë Modriq. "Këta lojtarë e kanë treguar që tani se sa vlejnë, falë aftësive që kanë, cilësive teknike dhe dëshirës për të fituar gjithnjë. Nuk e harrova, por ndër ta është edhe Camavinga, që është në formë dhe ka treguar se mund të luajë në çdo pozicion. Ka personalitet dhe është i rëndësishëm për ne. Ai është rritur shumë që kur ka ardhur këtu dhe ka ende mundësi përmirësimi, do të jetë ylli i ardhshëm", ka deklaruar Modriq.



# Denveri fiton edhe finalen e dytë ndaj Lakersave

**Denver, 17 maj** - Denver Nuggets, që zuri vendin e parë në Konferencën e Perëndimit gjatë sezonit të rregullt në NBA, i shfrytëzoi në maksimum dy ndeshjet në fushën e vet, duke i fituar të dyja. Denveri mundi me rezultat 108-103 Los Angeles Lakers në finalen e dytë të "play-off", duke udhëhequr 2-0 serinë e takimeve. Edhe kjo sfidë, ashtu si e para, ishte me shumë emocione e rivalitet deri në fund. Perioda e parë ishte e ekuilibruar dhe përfundoi 26-26. Në të dytën Lakersat kalojnë 5 pikë para. Edhe e treta është pak a shumë e barabartë, me vendasit që rikuperojnë vetëm 2 pikë. Perioda e katërt vulosi fatet e këtij takimi, ku Naggets fitojnë 32-24. LeBron James e Reaves realizuan nga 22 pikë secili për ekipin kalifornian, ndërsa Davis 18 pikë e 14 rebound, por që nuk mjaftuan për të fituar. Për Denver sërish shkëlqeu Jokiq me një "triple double", me 23 pikë, 17 rebound e 12 asistime, ndërkohë që shënuesi më i mirë për vendasit ishte Murray me 37 pikë e 10 rebound. Dy ndeshjet e radhës do të luhen në fushën e Lakersave.



# Presidenti i Formula 1: Anulimi i garave në Itali, vendim i duhur

**Imola, 17 maj** - Çmimi i madh i "Emilia Romagna" në Formula 1 fillimisht ishte planifikuar të zhvillohej të dielën në pistën ikonë të Imolas, por më në fund u anulua për shkak të përmbytjeve të tmerrshme në veri të Italisë. Shefi i Formula 1 Stefano Domenicali, i cili është nga rajoni, shprehu shqetësimin e tij për situatën. Duke folur për shtypin për të shpjeguar vendimin e tij, Stefano Domenicali kishte një mesazh prekës për qytetin e tij të lindjes. "Është një tragjedi e vërtetë të shohësh se çfarë ka ndodhur në Imola dhe në Emilia Romagna, qytetin dhe rajonin ku unë u rrita. Mendimet dhe lutjet e mia janë me viktimat e përmbytjeve dhe familjet dhe komunitetet e prekura". "Dëshiroj të shpreh mirënjohjen dhe admirimin tim për shërbimet e jashtëzakonshme të urgjencës që po punojnë pa u lodhur për të ndihmuar ata në nevojë dhe për të lehtësuar situatën – ata janë heronj dhe e gjithë Italia është krenare për ta", ka thënë presidenti i Formula 1. Vendimi për të anuluar GP në Imola për shkak të përmbytjeve ishte "i duhuri", thotë Domenicali "Vendimi që është marrë është i duhuri për të gjithë në komunitetet lokale dhe familjen e Formula 1", ka këmbëngul Domenicali. "Ne duhet të garantojmë sigurinë dhe të mos krijojmë një barrë shtesë për autoritetet ndërsa ata merren me këtë situatë të tmerrshme". Stefano Domenicali, presidenti aktual i Formula 1, është me origjinë nga Imola në Italinë veriore. Natyrisht, në sytë e tij, Çmimi i Madh i "Emilia Romagna" spikat si veçanërisht i rëndësishëm në kalendarin e garave. Për të, asgjë më e keqe nuk mund të kishte ndodhur.




SHKURT

## Shaqiri më i paguari në MLS, lë pas Insignen dhe Bernardeschin

Shumë yje të futbollit evropian janë duke zgjedhur vitet e fundit të luajnë në Amerikë. Paga është arsyeja kryesore pse emra të mëdhenj lënë disa prej kampionateve më elitare në Evropë për të luajtur në MLS. Faqja e statistikave të futbollit, "Transfermarkt" ka nxjerrë së fundmi një detaj shumë interesant. Mesfushori me origjinë shqiptare, Xherdan Shaqiri kryeson listën e pagesave, duke qenë më i paguari me plot 7.5 milionë euro në sezon dhe njëkohësisht duke lënë pas vetës emra të mëdhenj si Insigne me 6.9 milionë euro, Bernardeschi me 5.8 milionë euro por edhe shumë të tjerë.

## Marquinho rinovon kontratën me PSG-në

PSG-ja ka njoftuar zyrtarisht rinovimin e kontratës me qendërmbrojtësin brazilian, Marquinhos. Klubi francez dhe lojtari kanë refuzuar çdo ofertë të ardhur nga Premier Ligë, pasi vullneti ishte i të dyja palëve që ai të vazhdonte të vishte fanellën e PSG-së. Kontrata e Marquinhos do të jetë e vlefshme deri në qershor të vitit 2028. Pas këtij nënshkrimi, ka reaguar edhe presidenti Nasser Al Khelaifi.
"Marquinhos ka qenë duke luftuar gjithmonë për fanellën e PSG-së. më kujtojtohet kur ai u bashkua me klubin në moshën 19-vjeçare. Që nga dita e parë, ai tregoi dedikim serioz dhe një shpirt fitues", ka thënë Al Khelaifi.

## Dy klube angleze në garë për Manen

Manchester United dhe Newcastle raportohet se janë shfaqur si klubet më të mundshme për të nënshkruar me Sadio Manen. Bayern Munchen është i interesuar për të larguar anësorin pas një sezoni të mjerueshëm debutues. Ylli senegalez iu bashkua klubit gjerman vetëm verën e kaluar në një marrëveshje prej 27.4 milionë funtesh nga Liverpooli. "Sky Sport Germany" ka raportuar se Bayern pritet të shesë Mane këtë verë pas një sezoni të vështirë, ku ai ka shënuar vetëm 12 gola.

## Spalletti, afër largimit nga Napoli

Tensionet në rritje mes presidentit të Napolit, Aurelio De Laurentiis dhe trajnerit Luciano Spalletti janë bërë gjithnjë e më evidente ditët e fundit, dhe raportet në Itali pretendojnë se Rafa Benitez dhe Antonio Conte janë kandidatët kryesorë për të zëvendësuar trajnerin italian. Sipas "Il Corriere della Sera", kohëve të fundit ka pasur konflikte mes De Laurentiis dhe Spallettit, dhe si rezultat i kësaj e ardhmja e trajnerit që fitoi "Scudetton" duket të jetë larg Napolit.

## Allegri: Nuk mund të bënim më shumë se kaq

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri e gjen justifikimin për mosarritjen në finalen e Ligës së Evropës. Skuadra torineze u mund në shtesë nga Sevilla 2-1, por ishte dukshëm më inferiore se ekipi spanjoll në nivelin e lojës. "Në këto ndeshje të rëndësishme, detajet bëjnë diferencën. Ishte një ndeshje e mirë dhe këto janë hapat që djemtë, veçanërisht lojtarët e rinj, duhet të bëjnë. Ne mund të kishim bërë më mirë në disa episode. Kundërshtari ishte më mirë dhe zhvilloi një ndeshje të ekuilibruar. Si ne, edhe shumë ekipe të tjera nuk do të fitojnë trofe, por rritja e Juventusit kalon nëpër kësi ndeshjesh. E kisha vendosur formacionin kështu sepse Sevilla ka mbrojtës që vuajnë nga thellësia dhe Kean është i zoti për ta bërë këtë punë. Iling e bëri këtë, zhvilloi një ndeshje të mirë. Më vjen keq për djemtë, sepse e meritonin këtë finale, por nuk mund të bënim më shumë se kaq. Detajet bënë diferencën dhe ne paguam për mungesën e eksperiencës në situata të caktuara. Edicionin tjetër do të jemi më të përgatitur", ka deklaruar Allegri.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

**Datë, 20.05. 2023**

Në bazë të neneve 30, 31, 33 dhe 35 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, neneve 29, 30, 31, 32, 33 si dhe 34 të Statutit të Institutit të Historisë *"Ali Hadri"* në Prishtinë, dhe nenet 3, 5, 9, 11, 12 dhe 13 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë *"Ali Hadri"* nr. 01/50/20, Instituti i Historisë *"Ali Hadri"* në Prishtinë shpallë:

## KONKURS

1. 1 (Një) Bashkëpunëtor i lartë shkencor për fundin e shek. XX – zgjedhje/rizgjedhje.

**Kandidati/ja për Bashkëpunëtor të lartë shkencor (prof. asoc.) duhet t'i plotësojë këto kushte:**

- Të ketë gradën e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku tri (3) punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmisë përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit,
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit,
- Të ketë pjesëmarrje me kumtesa së paku në dy (2) konferenca, nga të cilat së paku një (1) të jetë ndërkombëtare.

**Dokumentacioni i nevojshëm**

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse,
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk është nën hetime,
- CV së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të,
- Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj).

Zgjedhja e personelit të Institutit të Historisë *"Ali Hadri"* bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Ligjit të Punës nr. 03/L212, Statutit të Institutit të Historisë *"Ali Hadri"*, dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në njërën nga gazetat ditore. Kërkesës i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës.

Kërkesat e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, (Ndërtesa e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës), Rr., „Arbnor e Astrit Dehari" nr.25 - 10000 Prishtinë.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512-303, prej orës 09:00 - 16:00.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

**Datum, 20.05. 2023**

Na osnovu članaka 30, 31, 33 i 35 Zakona br. 04/L-135 O Naučno-istraživačkoj Djelatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, br 11/02 Maj 2013); Član 8 Zakon o Radu Br. 03/L-212; članovi 29, 30, 31, 32, 33 i 34 Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini; i članovi 3, 5, 9, 11, 12 i 13 Uredba o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju, Br. 01/50/20, Institut za istoriju "Ali Hadri" u Prištini, objaviti:

## KONKURS

1. 1 (Jedan) Viši naučni saradnik za kraj XX veka– izbor/reizbor

**Kandidata za poziciju Viši naučni saradnik (Prof.asoc.) mora ispuniti sledeće uslove:**

- Da ima doktorat nauka,
- Imati najmanje tri (3) naučne radove objavljena u relevantnim međunarodnim časopisima unutar oblasti, najmanje dva (2) od njih moraju biti nakon poslednjih izbora,
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima unutar i izvan zemlje,
- Da učestvuje sa referatima na najmanje dva (2) konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna.

**Potrebna dokumentacija**

Kandidat mora da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Diplomu za završetak doktorskih studija,
- Izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
- Dokument izdat od nadležnog organa koji potvrdjuje da nisu pod istragom,
- CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj,
- Dokazi o naučnim dostignućima (članci, knjige itd.).

Izbor osoblja Instituta Istorija " Ali Hadri " bira se u skladu sa odredbama Zakona br . 04 / L - 135 za istraživačke- naucne aktivnosti - i Statuta Instituta Istorije "Ali Hadri ", Zakon o Radu, i Uredba o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim novinama, Zahtev se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira.

Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu: Institut Istorije u Prištini, (Zgrada Arhiva Kosova). (Zgrada Državne Agencije za Arhive Kosova), Ul. "Arbnor e Astrit Dehari" br.25 - 10000 Prishtinë.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovom Br . Tel: 038 / 512 303, od 09:00 do 16:00 časova.










## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Computer Management" SH.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811420893 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Computer Management" D.O.O. Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811420893 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Computer Management" L.L.C. with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 811420893 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valton Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

Negjmije Bungu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.

Emrije Vilaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Naim Frasheri " Vlashnje.

Xhelal Ninaj shpall te pavlefshme dëftesat e lp I - VIII shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

Erna Jamini shpall te pavlefshme dëftesat shfmu " Fetah Sylejmani " Dragash.

Enes Konjuhi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. I-V të shkollës " Nexhmi Mustafa" Besi Prishtinë.

Bleona Konjuhi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I-V të shkollës "Nexhmi Mustafa" Besi Prishtinë.

Amanta Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Mentori B.I shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 601640726.

- Afrim Smjali shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ''Arkitekt Sinani''.

- Autoservis Beni-VW AUDI-VAG shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 80273029.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues